

VENDIM
Nr. 533, datë 29.7.2022

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E
MASAVE PËR IMPORTET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 4, të ligjit nr. 9790, datë 19.7.2007, “Për masat mbrojtëse në importe”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e masave për importet, si më poshtë vijon:

- a) Znj. Delina Ibrahimaj, ministër i Financave dhe Ekonomisë, kryetar;
- b) Znj. Elira Demiraj, drejtor i përgjithshëm i Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, anëtar;
- c) Z. Nikolla Lera, drejtor i përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, anëtar;
- ç) Z. Alban Mësonjësi, drejtor i Programit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
- d) Znj. Elona Boci, specialiste e Drejtorisë së Diplomacisë Ekonomike në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, anëtar;
- dh) Z. Bashkim Sykja, përfaqësues i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, anëtar;
- e) Z. Ylber Karanxha, zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, anëtar;
- ë) Znj. Arjana Dyrmishi, drejtor i Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, anëtar.

2. Vendimi nr. 317, datë 12.4.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e masave për importet”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe komisioni për vlerësimin e masave për importet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama